



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lezhë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022

**Shtojca 10**

*[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

01/06/2022

Drejtuar: OE “INFOSOFT OFFICE” SH.P.K, me adrese Koder Kashar, Autostrada Tirane - Durres, Km 8, Kashar, Tirane.

Procedura e prokurimit/ lotit: E Hapur e thjeshtuar/ Mallra

Numri i procedurës/ referenca e Lotit: REF-29227-05-16-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale kancelarie per nevoja te Bashkise Lezhe per vitin 2022”.

Kohëzgjatja e kontratës: 30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “INFOSOFT OFFICE” SH.P.K, me Nuis J62426002Q, me oferte ekonomike 2,407,117 (dy milion e katerqind e shtate mije e njeqind e shtatembedhjete) Lek pa TVSH,
2. Operatori Ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” SH.P.K, me Nuis L91418502J, me oferte ekonomike 2,626,000 (dy milion e gjashteqind e njezet mije) Lek pa TVSH,
3. Operatori Ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” SH.P.K, me Nuis J72124001N, me oferte ekonomike 2,553,972.5 (dy milion e peseqind e pesedhjete e tre mije e nenteqind e shatedhjete e dy pike pese) Lek pa TVSH.

4. Operatori Ekonomik “OFFICE CENTER” SH.P.K, me Nuis K41425042N, me oferte ekonomike 2,791,670 (dy milion e shtateqind e nentedhjete e nje mije e gjashteqind e shtatedhjete) Lek pa TVSH.

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “OFFICE CENTER” SH.P.K me Nuis K41425042N,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.1 te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se:

*“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

*Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetoje duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate;*

*ose*

*b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetoje duke paraqitur faturat tatimore te shitjes ku shënohen mallrat, shumat dhe vlerat”.*

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se OE nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per te provuar plotesimin e ketij kriteri.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.2 te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se:

*“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të gjithë sasise se mallit të përfshire në këtë procedure prokurimi”, pasi nga verifikimi ne SPE, rezulton se OE nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe provon plotesimin e ketij kriteri.*

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 76, pika 3/a dhe ne nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet

---

nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “OFFICE CENTER” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

***Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “OFFICE CENTER” SH.P.K me Nuis K61625001I, skualifikohet.***

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “INFOSOFT OFFICE” SH.P.K, me adrese Koder Kashar, Autostrada Tirane -Durrës, Km 8, Kashar, Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 2,407,117 (dy milion e katerqind e shtate mije e njeqind e shtatembedhjete) Lek pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
KRYETARI  
Pjerin NDREU**

---